



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komunal Rahovec/ Opštine Orahovac/Municipal Rahovec



Në bazë të nenit 12 të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) nenit 15 pika f të Ligjit për Financa e Pushtetit Lokal Nr.03/ L -049 të datë 13.03.2008 , neni 8 paragrafi 1 pika 3 dhe nenit 15 paragrafi 1 pika 8 të Ligjit për Mbeturina Nr.04 / L – 060 të datës 24.05.2012 , nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit të 01Nr.569/1 të datës.16.12.2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më 9 dhjetor 2015, merr këtë :

RREGULLORE PËR PLOTËSIM TË RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË RAHOVECIT 01 NR. 239 TË DATËS 30.01.2015.

- I. Me këtë Rregullore plotësohet Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës së Rahovecit 01 Nr. 239 të datës 30.01.2015, si vijon:
Në nenin 9 të kësaj Rregulloreje pas pikës 9.7 të shtohet pika 9.8 dhe atë:
"9.8 – Tarifa për mbledhjen e mbeturinave për vitin 2016".
- II. Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje është pasqyra tabelare e tarifave për mbledhjen e mbeturinave.
- III. Për zbatimin e kësaj rregullore do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së si dhe pas publikimit të ueb faqen e komunës.

01 Nr. 4103
Rahovec, 09.12.2015

Kuvendi i Komunës së Rahovecit

 REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 4103 Më Dt. 09.12 2015
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC



Kryesuesi i Kuvendit

Nahit Elshani